



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 42 Prot

Tiranë, më 03/10/2011

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit **Klinika private Diplomat, Tiranë.**

VENDIM

Nr. 5, datë 03/10/2011

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të Klinikës private Diplomat, Tiranë ;

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm parashikohet : “Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri.

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana e jonë, me shkresën nr.1929 prot, datë 24.03.2011, ju është dërguar një informacion me shpjegimet se si do të plotësoni formularin e njoftimit të të dhënave personale që përpunoni, duke ju caktuar një afat për plotësimin e këtij detyrimi, datë 24.04.2011.

Po kështu nga verifikimi e regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit të këtij institucioni rezulton se deri më datë 30.09.2011, ende nuk keni depozituar formularin e plotësuar të njoftimit.

